



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 30, Datë 03.02.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“DELIU 3D” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.02.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 186/1 prot., datë 30.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “DELIU 3D” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186 prot., datë 17.01.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1.600 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b” “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmën “c”; si dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “DELIU 3D” sh.p.k.:
  - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., datë 29.08.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentralit “Shiroku” me kapacitet prodhues 1.600 MW, në pellgun ujëmbledhës të

*përroit të Holtës dhe të përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”;*

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 13114/3 prot., datë 15.01.2025;
  - Ka depozituar në ERE Vendim nr. 17, datë 08.05.2023 *“Për miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k.” të Këshillit të Basenit Ujq Seman, si dhe Lejen për përdorimin e Burimit Ujq sipërfaqësor nr. 450 prot., datë 11.05.2023, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujq (KBU) Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është 5 vjet.*
  - Ka depozituar Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 07.06.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i HEC Shiroku”, me fuqi të instaluar 1600 kW, nga shoqëria “DELIU 3D” sh.p.k.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka dorëzuar dokumentet e mëposhtme në format fotokopje apo në format elektronik. Në përputhje me përcaktimet e nenit 8, pika 3 të Rregullores, shoqëria duhet të dorëzojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin si më poshtë:
- *Kontratën nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., datë 29.08.2018, të nënshkruar me MIE-n, si dhe Kontratën shitesë nr. 722 rep., nr 199 kol., datë 19.04.2024, e cila nuk rezulton të jetë depozituar;*
  - *Kontratën e Kredisë Bankare Afatgjatë;*
  - *Vendimin nr. 17, datë 08.05.2023 të KBU Seman dhe Lejen për përdorimin e Burimit Ujq sipërfaqësor;*
  - *shkresën e “OSSH” sh.a. “Miratim pikë lidhje për HEC Shiroku”.*
- Po ashtu nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

##### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin që tregon se nuk ka detyrime të pashlyera në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke u referuar periudhës së aplikimit në ERE. Vërtetimet dhe deklaratat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 (një) muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.
- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE aftësinë financiare për realizmin e investimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria ka marrë kredi nga banka në një vlerë më të vogël se sa ishte parashikuar në planin e biznesit, rreth 40%, krahasuar me 80% që kishte planifikuar. Po ashtu, shoqëria nuk ka bërë me dije mbi burimet e tjera të financimit dhe dokumentacionin në të cilin mbështet financimin e investimit.

- Po ashtu, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake (e vlefshme deri më 07.06.2026) dhe duke qenë se në shtojcën 2 shoqëria ka deklaruar se viti i ndërtimit të hidrocentralit është 2024-2025, por shoqëria nuk ka informuar nëse punimet për ndërtimin e tij kanë filluar, vlerësohet t’i kërkohej ky informacion në vijim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1.600 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DELIU 3D” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**